

VENDIM
Nr.646, datë 29.12.1999

**PËR MBËSHTETJE FINANCIARE TË VEPRIMTARISË SË QENDRËS SË REALIZIMIT
TË VEPRAVE TË ARTIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, me propozimin e Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1.Qendra e realizimit të veprave të artit të funksionojë pranë Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, me një organikë prej 17 vetash.

2.Efektet financiare, në masën 2630 mijë lekë, për shpenzimet e kryera nga kjo qendër gjatë periudhës maj-dhjetor të vitit 1999, të përballohen nga fondi buxhetor i miratuar për Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, për vitin 1999.

3.Ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, brenda datës 30.12.2000, të paraqesë për mirati, pranë Kryeministrit, ndryshimet përkatëse në strukturën organizative të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporteve.

4.Ngarkohet Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta